



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1. nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafin 63.1.1. nënparagrafi a) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Engineering RK Sh.P.K. & Nika Proing Sh.P.K." të datës 25.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 20.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rikonstruimi i kulmit të objektit të Komunës së re" me nr. të prokurimit 616-22-14609-5-1-1 dhe me nr. të brendshëm 616 22 220 511, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Engineering RK Sh.P.K. & Nika Proing Sh.P.K." e datës 25.04.2023 kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 20.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rikonstruimi i kulmit të objektit të Komunës së re" me nr. të prokurimit 616-22-14609-5-1-1 dhe me nr. të brendshëm 616 22 220 511.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi. Autoriteti Kontraktues, për nënshkrim të kontratës, duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën autoriteti kontraktues ka marrë këtë vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "Engineering RK Sh.P.K. & Nika Proing Sh.P.K." si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Engineering RK Sh.P.K. & Nika Proing Sh.P.K." (tutje si "parashtruesi") me datë 25.04.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 20.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Rikonstruimi i kulmit të objektit të Komunës së re" me nr. të prokurimit 616-22-14609-5-1-1 dhe me nr. të brendshëm 616 22 220 511.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) - *“Menaxher të projektit ingjinerin e ndertimtarise z. Bexhet Baftiaraj, i cili e ploteson kushtin e pare, por nuk e ploteson kerkesen qe te jete edhe ingjiner i ndertimtarise pasi me vendim eshte bere menagjer projekti”.*

Pretendimi i dytë (II) - *“Aneksi 7 nuk e ka dorezuar jo konform kerkesa ne FDT-se”.*

Pretendimi i tretë (III) - *“Ne cmimin e ofruar OE eshte i papergjeshem ne baze te RROUP dhe rregullores se LPP-se pasi qe eshte me cmim te ulet jo normalishte i cili e ploteson kushtin e mesatere qe eshte 30% me lire se OE tjere dhe e ploteson kushtin qe eshte me lire se 10% qe rendite i dyte”.*

Pretendimi i katërt (IV) - *“Ne kerkesen e DT eshte kerkuar sigurim i tenderit per 90 dite, data e hapjes ka qen 13.02.2023 mirpo ne sigurimin e tenderit OE e ka cekun qe sigurimi vlen nga data 14.02.2023 do te thote ditën e aplikimit nuk ka pasun sigurim te ofertes Ne faqen e dyte te sigurimit ceket Periudha e sigurimit ashte nga 14.02.2023 – deri 14.06.2023”.*

Pretendimi i pestë (V) - *“Ne Dosjen e tenderit kerkohet qe Kontrata për marrëdhënie pune, ose marrëveshje për angazhim për këtë projekt i OE ne kete raste ka ofruar kontrate me z. Lumidin Asllani ingjineri i arkitektures nuk ka kontrate aktive pasi qe ka lidhun kontrate pune 01.03.2022 – 01.03.2023 dhe i njejt shifet se e ka fallcifikuar nenshkrimin e ingjinerit dhe vulen e OE”.*

Pretendimi i gjashtë (VI) - *“Ne Dosjen e tenderit kerkohet qe Kontrata për marrëdhënie pune, ose marrëveshje për angazhim për këtë projekt i OE ne kete raste ka ofruar kontrate me z. Karafidin Kuka ingjineri i njertimtarise nuk ka kontrate aktive pasi qe ka lidhun kontrate pune 01.03.2022- 01.03.2023”.*

Pretendimi i shtatë (VII) - *“Ne Dosjen e tenderit kerkohet qe Kontrata për marrëdhënie pune, ose marrëveshje për angazhim për këtë projekt i OE ne kete raste ka ofruar kontrate me z. Kushtrim Bajrami ingjineri i hidros nuk ka ofruar kontrate fare”.*

Pretendimi i tetë (VIII) - *“Qarkullimin dyshojm se nuk e ploteson pasi ne qasjen e tenderit OE u kon me kerkes te konfidencialitet, ne listimin e kontratave nuk e ploteson kushtin”.*

Për shkak të pretendimeve si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 60 dhe 69 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje “LPP”).

Pas njoftimit për zgjatje të afatit për shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim në përputhje me nenin 61 paragrafin 61.3 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (tutje "RRPP"), autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 04.05.2023 ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim.

Për shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit, janë administruar këto prova materiale:

- B05 Njoftimi për kontratë i dt. 05.01.2023.
- Dosja e tenderit të dt. 20.01.2023.
- Oferta e tenderuesit të rekomanduar për kontratë.
- Procesverbali i hapjes së dt. 14.02.2023.
- B41 Letra mbi tenderin jo-normalisht të ulët e dt. 29.03.2023.
- Përgjigja e tenderuesit në B54 kërkesën për tenderin jonormalisht të ulët e dt. 30.03.2023.
- Raporti i vlerësimit të tenderëve i dt. 20.04.2023.
- Njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues i datës 20.04.2023.
- Letra standarde për tenderuesin e eliminuar të datës 20.04.2023.

Pas trajtimit të kërkesës për rishqyrtim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimet e tij. Po ashtu nga provat e administruara nuk është arritur që të vërtetohen pretendimet e parashtruesit sipas nenit 62 paragrafit 62.1 nënparagrafi d) të RRPP.

Lidhur me pretendimin e parë (I) është administruar si provë oferta e tenderuesit të rekomanduar ku është gjetur se z. Bexhet Baftjaraj ka dorëzuar diplomën e cila dëshmon se i njëjtë është inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë. Njëkohësisht është gjetur se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar në kuadër të ofertës edhe vendimin për caktimin e personit në fjalë si menaxher të projektit. Në anën tjetër përmes dosjes së tenderit është kërkuar që "*një inxhinier të arkitekturës ose të ndërtimtarisë min. 5 vite përvojë të punës pas diplomimit, (të caktohet) menaxher i projektit*". Në këtë mënyrë është gjetur se tenderuesi i rekomanduar e ka plotësuar këtë kriter në dosje të tenderit, sikurse që është konstatuar edhe në raportin e komisionit të vlerësimit. Rrjedhimisht pretendimi i parë i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) parashtruesi ka pretenduar se tenderuesi i rekomanduar nuk e ka dorëzuar aneksin 7 në përputhje me kërkesat e FDT mirëpo nuk ka specifikuar se cilat janë arsyet për të cilat tenderuesi e ka bërë një veprim të tillë. Me fjalë të tjera parashtruesi është dashur që të specifikoj saktësisht përse aneksi 7 në ofertën e tenderuesit të rekomanduar nuk është në përputhje me dosjen e tenderit. Rrjedhimisht parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument për të mbështetur pretendimin e tij. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i dytë i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë (III) fillimisht duhet cekur se parashtruesi nuk ka sqaruar përse oferta e tenderuesit të rekomanduar është 10% më e ultë se oferta e tenderuesit të dytë më të lirë. Në anën tjetër nga analizimin i procesverbalit të hapjes së tenderëve dhe

njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues, është gjetur se çmimi i ofertuar nga tenderuesi i rekomanduar nuk është më i ulët se 10% sesa çmimi i ofertuar nga tenderuesi i dytë më i lirë. Pavarësisht këtij fakti autoriteti kontraktues me datë 29.03.2023 ka dërguar te tenderuesi i rekomanduar B41 Letra mbi tenderin jo-normalisht të ulët me ç'rast ka kërkuar sqarime shtesë për të bindur autoritetin kontraktues se çmimi i ofertuar nuk është çmim jonormalisht i ulët. Tutje me datë 30.03.2023 tenderuesi i rekomanduar ka kthyer përgjigje në kërkesën e autoritetit kontraktues ashtu që ka ofruar sqarimet se çmimi i ofertuar nuk përbën çmim jonormalisht të ulët. Komisioni vlerësues e ka analizuar me kujdes këtë përgjigje dhe ka arritur deri te konstatimi që sqarimet e tenderuesit janë të argumentuara dhe bindëse për autoritetin kontraktues. Në këtë mënyrë pas administrimit të këtyre provave materiale është gjetur se oferta e tenderuesit të rekomanduar nuk përmban çmim jonormalisht të ultë. Prandaj edhe pretendimi i tretë i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e katërt (IV) është administruar si provë polica e sigurimit të tenderuesit të rekomanduar me ç'rast është gjetur se sigurimi i tenderit të tij vlen nga data 13.02.2023 deri me 13.06.2023, pikërisht siç është kërkuar edhe me dosjen e tenderit. Prandaj pretendimi i katërt i parashtruesit nuk qëndron aspak dhe është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e pestë (V), gjashtë (VI) dhe shtatë (VII) parashtruesi pretendon se kualifikimet e punonjësve Lumidin Asllani, Karafidin Kuka dhe Kushtrim Bajrami nuk janë në përputhje me dosjen e tenderit përkatësisht të njëjtit nuk kanë kontratë aktive me tenderuesin e rekomanduar. Prandaj është administruar si provë lista e punonjësve që është pjesë e ofertës së tenderuesit ku është gjetur se këta punonjës nuk janë fare në këtë listë. Me fjalë tjera tenderuesi i rekomanduar nuk ka ofertuar fare me këta punonjës por me punonjës krejt të tjerë të cilët sipas raportit të komisionit vlerësues i plotësojnë në tërësi kriteret e dosjes së tenderit. Rrjedhimisht është gjetur që edhe këto pretendime të parashtruesit janë tërësisht të pabazuara.

Lidhur me pretendimin e tetë (VIII) parashtruesi ka potencuar që dyshon se qarkullimi i tenderuesit të rekomanduar nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderin. Mirëpo parashtruesi nuk ka arritur të sqarojë që sipas pretendimit të tij ankimor cilat janë arsyet sipas të cilave tenderuesi i rekomanduar nuk e plotëson cilin kriter të dosjes së tenderit. Me fjalë të tjera parashtruesi është dashur që të specifikojë saktësisht përse qarkullimi i tenderuesit të rekomanduar nuk është në përputhje me dosjen e tenderit. Rrjedhimisht parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë argument për të mbështetur pretendimin e tij. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimi i tetë i parashtruesit është tërësisht i pabazuar.

Sipas trajtimit dhe elaborimeve më lartë në këtë vendim është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimet e parashtruesit janë tërësisht të pabazuara. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin a) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të RRPP.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 04.05.2023

Visar SHEHU
Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.